

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil me gjyqtaren Afijete Sada Gllgjani dhe procesmbajtësja Miranda Marku praktikante, në çështjen juridike të paditësve 1. I. K., 2. B. Xh., 3. S. S., 4. D. M., 5. R. B., 6. M. L. dhe 7. Xh. M. që të gjithë nga Gjakova, të përfaqësuar nga i autorizuari B. Sh., punëtor i SBASHK-ut, kundër të paditurës K. Gj. D. A., për kontest pune kompensim të pagave për përcjellje në pension dhe shpërblim jubilar, vlera kontestit 16.785.45 € në shqyrtimin kryesor të mbajtur me 26 dhjetor 2018 në prezencën e të autorizuarit të paditësve dhe në mungesë të paditurës, murr këtë;

A K T G J Y K I M

I. DETYROHET e paditura K. Gj. D. A. që paditësit **I. K.** nga Gjakova në emër të kompensimit të tri pagave bazë përcjellëse me rastin e pensionimit të ia paguajë shumën prej nga 440.13 € shumën prej 1320.39 € dhe në emër të tri pagave bazë për shpërblim jubilar në vlerë prej nga 405.00 € shumën prej 1215.00 euro, në shumën e tërësishme prej 2535.39 € (dymijepesëqind e tridhjetepesë euro e tridhjetë e nëntë centë) si dhe shpenzimet procedurale në shumë 30.00 €, krejt këto në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit.

II. DETYROHET e paditura K. Gj. D. A. që paditëses **B. Xh.** nga Gjakova në emër të kompensimit të tri pagave bazë përcjellëse me rastin e pensionimit të ia paguajë shumën prej nga 472.19 € shumën prej 1416.57 € dhe në emër të tri pagave bazë për shpërblim jubilar në vlerë prej nga 405.00 € shumën prej 1215.00 €, në shumën e tërësishme prej 2631.57 € (dymijegjashtëqindetridhjetenjë euro e pesëdhjeteshtatë centë) si dhe shpenzimet procedurale në shumë 40,00 €, krejt këto në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit.

III. DETYROHET e paditura K. Gj. D. A. që paditësit **S. S.** nga Gjakova në emër të kompensimit të tri pagave bazë përcjellëse me rastin e pensionimit të ia paguajë shumën prej nga 260.00 € shumën prej 780.00 € dhe në emër të tri pagave bazë për shpërblim jubilar në vlerë prej nga 232.00 € shumën prej 696.00 €, në shumën e tërësishme prej 1476.00 € (njëmijekatërqind e shtatëdhjetegjashtë euro) si dhe shpenzimet procedurale në shumë 30.00 €, krejt këto në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit.

IV. DETYROHET e paditura K. Gj. D. A. që paditëses **D. M.** nga Gjakova në emër të kompensimit të tri pagave bazë përcjellëse me rastin e pensionimit të ia paguajë shumën prej nga 478.27 € shumën prej 1434.81€ dhe në emër të tri pagave bazë për shpërblim jubilar në vlerë prej nga 405.00€ shumën prej 1215.00 €, në shumën e tërësishme prej 2649.81€ (dymijegjashtëqind e katër dhjetë e nëntë euro e tetëdhjetë e një centë) si dhe shpenzimet procedurale në shumë 40.00 euro, krejt këto në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit.

V. DETYROHET e paditura K. Gj. D. A. që paditëses **R. B.** nga Gjakova në emër të kompensimit të tri pagave bazë përcjellëse me rastin e pensionimit të ia paguajë shumën prej nga 420.19€ shumën prej 1260.57 € dhe në emër të tri pagave bazë për shpërblim jubilar në vlerë prej nga 405.00 € shumën prej 1215.00 €, në shumën e tërësishme prej 2475.57 € (dymijekatërqind e shtatëdhjetë e pesë euro e pesëdhjetë e shtatë centë) si dhe shpenzimet procedurale në shumë 40.00 €, krejt këto në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit.

VI. DETYROHET e paditura K. Gj. D. A. që paditësit **M. L.** nga Gjakova në emër të kompensimit të tri pagave bazë përcjellëse me rastin e pensionimit të ia paguajë shumën prej nga 459.09€ shumën prej 1377.27€ dhe në emër të tri pagave bazë për shpërblim jubilar në vlerë prej nga 405.00€ shumën prej 1215.00 €, në shumën e tërësishme prej 2592.27€ (dymijepesëqind e nëntëdhjetë e dy euro e njëzet e shtatë centë) si dhe shpenzimet procedurale në shumë 40.00€, krejt këto në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit.

VII. DETYROHET e paditura K. Gj. D. A. që paditësit **Xh. M.** nga Gjakova në emër të kompensimit të tri pagave bazë përcjellëse me rastin e pensionimit të ia paguajë shumën prej nga 403.27€ shumën prej 1209.81 € dhe në emër të tri pagave bazë për shpërblim jubilar në vlerë prej nga 405.00€ shumën prej 1215.00 €, në shumën e tërësishme prej 2 424.81€ (dymijekatërqindnjëzet e katër euro tetëdhjetenjë centë) si dhe shpenzimet procedurale në shumë 40.00 €, krejt këto në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësit me padi, parashtresa nëpërmjet të autorizuarit të tyre kanë parashtruar se kanë qenë në marrëdhënie të rregullt pune te e paditura dhe kanë punuar në cilësinë e mësimdhënësve dhe punëtorëve teknik atë deri në kohën e pensionimit. Pas pensionimit, paditësve ju ka takuar e drejta në nga tri paga përcjellëse, në lartësi të tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit dhe e drejta në tri paga jubilarë. Bazën ligjore të padisë e mbështetin në Kontratën Kolektive të Arsimit Parauniversitar të datës 11 prill 2014 sipas së cilës me dispozitat e nenit 36.9 thuhet “ Punëtorët që dalin në pension përfitojnë shpërblim jubilar në vlerë siç vijon;

7.1 për 10 vjet të përvojës së punës te punëdhënësi i fundit në vlerë të një page bazë,
7.2 për 20 vjet të përvojës së punës te punëdhënësi i fundit në vlerë të dy pagave bazë,
7.3 për 30 vjet të përvojës së punës te punëdhënësi i fundit në vlerë të tri pagave bazë,
7.4 punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblimin jubilar,
7.5 Shpërblimet jubilar paguhen nga punëdhënësi në afatin prej 1 muaji pas plotësimit të kushteve”.

Më tutje sipas dispozitave të nenit 36.10 “ Punëtorët që dalin në pension përfitojnë pagesë përcjellëse në lartësi të tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit.”

Sa i përket përgjigjes në padi i autorizuari i paditësve e ka konsideruar si të pabazuar dhe pa mbështetje ligjore.

Në fjalën përfundimtare i autorizuari i paditësve ka propozuar që kërkesë padia e precizuar të aprovohet si e bazuar. Kamatën ligjore nuk e kërkoi.

Shpenzimet procedurale u kërkuan për taksa për padi.

E paditura me përgjigje në padi ka parashtruar se sipas dispozitave ligjore të cilat kanë qenë në fuqi të drejtat dhe detyrimet e personelit të punësuar në Ministrinë e Arsimit janë të rregulluara me Ligjin e Punës nr.03/L-212 i cili nuk ka paraparë asnjë beneficion apo privilegj për personat të cilëve ju ndërprehet marrëdhënia e punës sipas fuqisë ligjore, me mbushjen e moshës së pensionimit.

Ish Ministri i MASHT-it Ramë Buja me kryetarin e SBASHK- ut Rrahman Jasharaj kanë nënshkruar Kontratën Kolektive të Arsimit Parauniversitar ku sipas nenit 2 zbatimi i Kontratës është për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private para universitare në mbarë territorin e Republikës së Kosovës të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut. Në nenin 36 rregullohet garantimi i pagave dhe sipas pikës 9 anëtarët e SBASHK-ut –punëtorët që dalin në pension përfitojnë shpërblim jubilar, por kontrata nuk është e zbatueshme dhe nuk mund të ketë efekt retroaktiv.

Bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të nënshkruar me datë 18 prill 2017 në mes të Arsim Bajrami - Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Rrahman Jasharaj - Kryetar i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës përkundër nenit 46 të asaj Kontrate, nga ana e MASHT- it dhe SBASHK- ut nuk janë angazhuar për të i informuar dhe ndihmuar Komunat që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe kostos buxhetore për zbatimin e asaj Kontrate në Ministrinë e Financave me qëllim të realizimit të buxhetit. U propozua që kërkesëpadia e paditësve të refuzohet si e pa bazuar.

Shqyrtimin kryesor të treguar me datën 27 dhjetor 2018 Gjykata e ka mbajtur në mungesë të paditurës të ftuar në mënyrë të rregullt me propozimin e të autorizuarit të paditësve bazuar në nenin 423.4 të LPK.

Për të vendosur në këtë çështje juridike Gjykata bëri nxjerrjen e provave si ; vendimit 04 nr.118-34124 datë 18 maj 2015, vërtetimit numër 87/2018 të datës 20 nëntor 2018, transaksionit të datës 21 nëntor 2018 R. B., vërtetimit të DKA pa datë, për I. K., vendimi 04 nr. 118-59942 datë 2 shtator 2015, vërtetimit numër 300/2016 të datës 5 dhjetor 2016, listës së pagave për muajt tetor, nëntor, dhjetor 2015, vërtetimeve nr. 136-2/2018 dhe 136/2018 të datës 29 tetor 2018 për B. Xh., vendimit 04 nr. 118-21262 datë 16 mars 2015, vërtetimeve nr. 156/2018 dhe nr.156-2/2018 të datës 27 nëntor 2018, transaksionit të datës 27 nëntor 2018 R. B. për S. S.. vendimit 04 nr.112-34112 datë 18 maj 2015, vërtetimin e datës 16 nëntor 2018, vërtetimit nr.1898 të datës 29 dhjetor 2016, vërtetimit nr. 1894 datë 23 dhjetor 2016, vërtetimet të datës 16 nëntor 2018, listat e pagave për muajt mars, prill, maj 2015 për D. M., vendimit 04 nr. 118-59948 datë 2 shtator 2015, vërtetimit nr.1896 të datës 27 dhjetor 2016, deklarata e llogarisë P.C. B. datë 27 dhjetor 2016 për R. B., vendimit 04 nr.118-59931 datë 2 shtator 2015, vërtetimet nr. 216 datë 22 dhjetor 2016, vërtetimeve të datës 30 tetor 2018 nr.335 dhe nr.337, deklaratës së llogarisë P.C. B. të datës 19 nëntor 2018 për M. L., vendimit 04 nr.118-59955 të datës 2 shtator 2015, vërtetimit nr. 95/2018 datë 20 nëntor 2018, vërtetimit nr. 96/2018 të datës 20 nëntor 2018, deklaratës së llogarisë në P.C.B. së datës 20 nëntor 2018 për Xh. M., ku pas vlerësimit veç e veç të këtyre provave dhe në lidhshmërinë e tyre reciproke gjeti se kërkesë paditë e precizuara të paditësve janë të bazuara dhe si të tilla u aprovua.

K. e Gj.-D. e A., paditësit të parë I. K. data e lindjes . . . , i punësuar në punët dhe detyrat e punës si mësimdhënës në SHFMU “ K. i M. “ D. i ndërpreu kontratën e punës me datë 31 maj 2015 për shkak të daljes në pension, mbushjes së moshës 65 vjeç.

Me Vërtetimet e DKA-së dhe të asaj Shkolle vërtetohet se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune si mësimdhënës që nga ata 1 shtator 1975 deri në pensionim dhe ka përvojë pune mbi 38 vite.

Nga gjendja bankare e datës 1 janar 2017 dhe 21 janar 2018 R. B. vërtetohen pagat e realizuara neto për muajin mars 2015 ka qenë në shumë prej 400.46€, për muajin prill 2015 në shumë 440.14€ ndërsa për muajin maj 2015 në shumë prej 448.74€ nga u vërtetua lartësia kërkesëpadisë së

aprovuar.

K. e Gj.-D. e A., paditëses së dytë B. Xh. data e lindjes . . . e punësuar në punët dhe detyrat e punës si mësimdhënëse në SHMU "M. K. " Gjakovë, i ndërpre në kontratën e punës me datë 31 dhjetor 2015 për shkak të daljes në pension dhe mbushjes së moshës 65 vjeç.

Me Vërtetimet e asaj shkolle vërtetohet se paditësja ka 42 vite përvojë pune si mësimdhënëse.

Nga Lista e pagave vërtetohet se e njëjta ka realizuar pagat për tre muajt e fundit para pensionimit për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor 2015 shumat nga 472.19€ (paga neto) nga u vërtetua lartësia e kërkesëpadisë së aprovuar.

K. Gj. D. A., paditësit të tretë S. S. data e lindjes . . . i punësuar në punët dhe detyrat e punës si tekniko shërbyes në SHMU " M. K. " Gjakovë i ndërpre në kontratën e punës me datë 30 prill 2015 për shkak të daljes në pension, mbushjes së moshës 65 vjeç.

Me vërtetimet e asaj Shkolle vërtetohet se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune nga data 1 janar 1976 e deri me 30 prill 2015 dhe ka mbi 39 vite përvojë pune.

Nga Historiati i llogarisë së R. B. të datës 27 tetor 2018, për paditësin S. lidhur me ekzekutimin e pagave të realizuara për muajt shkurt, mars 2015 kanë qenë në shumë prej 241.28 € ndërsa për muajin prill 2015 ka qenë shuma prej 251.42€ nga u vërtetua lartësia e kërkesëpadisë së aprovuar.

K. Gj. D. A., paditëses së katërt D. M. data e lindjes . . . e punësuar në punët dhe detyrat e punës si mësimdhënëse në SHMU " M. B. " Gjakovë i ndërpre në kontratën e punës me datë 30 qershor 2015 për shkak të daljes në pension, mbushjes së moshës 65 vjeç.

Me Vërtetimin e asaj Shkolle vërtetohet se paditësja ka punuar si mësimdhënëse dhe ka mbi 42 vite përvojë pune.

Nga Listat e pagave për paditësen D. M. vërtetohet se paga për muajin prill 2015 ka qenë në shumë prej 478.27€ ndërsa për muajt maj, qershor 2015 në shumë prej 488.59€ nga u vërtetua lartësia e kërkesëpadisë.

K. Gj. D. A., paditëses pestë R. B. data e lindjes . . . e punësuar në punët dhe detyrat e punës si mësimdhënëse në SH.M.U " M. B." Gjakovë i ndërpre në kontratën e punës me datë 31 tetor 2015 për shkak të daljes në pension dhe mbushjes së moshës 65 vjeç.

Me Vërtetimin e asaj Shkolle vërtetohet se paditësja R. ka filluar punën nga data 01 nëntor 1971 deri në pensionim dhe ka mbi 42 vite përvojë pune.

Nga Deklarata e llogarisë së P.C. Bank datë 27 dhjetor 2018 lidhur me ekzekutimin e pagave të realizuara për muajt gusht , shtator, tetor 2015 vërtetohet se pagat neto kanë qenë në shumë prej 473.91€ nga u vërtetua lartësia e kërkesëpadisë së aprovuar.

K. Gj. D. A., paditësit të gjashtë M. L.data e lindjes . . . i punësuar në punët dhe detyrat e punës mësimdhënëse në SHMU " P. M. " G. , i ndërpre në kontratën e punës me datë 30 shtator 2015 për shkak të daljes në pension dhe mbushjes së moshës 65 vjeç.

Me Vërtetimin e asaj Shkolle vërtetohet se paditësi M. ka mbi 42 vite përvijë pune.

Nga Deklarata e llogarinë e P.c. B. të datës 19 nëntor 2018 lidhur me ekzekutimin e pagave të realizuara për muajt korrik 2015 ka qenë në shumë prej 459.09€ ndërsa për muajt gusht, shtator 2015 shumë nga 457.36€ nga u vërtetua lartësia kërkesëpadisë së aprovuar.

K. Gj. D. A., paditësit të shtatë Xh. M. data e lindjes . . . i punësuar në punët dhe detyrat e punës si mësimdhënësi në SHFMU " D. e H. " H. i ndërprente kontratën e punës me datë 30 shtator 2015 për shkak të daljes në pension dhe mbushjes së moshës 65 vjeç.

Me Vërtetimet e asaj shkolle vërtetohet se paditësi Xh. ka qenë në marrëdhënie punë nga 1 shtator 1972 deri në pensionim dhe ka mbi 40 vite përvijë pune.

Nga Deklarata e llogarisë së P.C.B. të datës 20 nëntor 2018 lidhur me ekzekutimin e pagave të realizuara për muajt korrik , gusht, shtator 2015 kanë qenë në shumë prej 457.36€ nga u vërtetua lartësia e kërkesës së aprovuar.

Sipas Kontratës Kolektive të Arsimit Parauniversitar që ka hyrë në fuqi me datë 11 prill 2014 e lidhur në mes të Kryetarit të SBASHK- ut dhe Ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), e cila Kontratë për implikimet financiare sipas nenit 51, dispozitat e kësaj Kontrate kanë filluar të zbatohet nga data 01 janar 2015 që ka efekt juridik në këtë çështje lëndore.

Neni 36 pika 9 e Kontratës punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) që dalin në pension përfitojnë shpërblim jubilar në vlerë;

- 9.1 për 10 vjet të përvijës së punës te punëdhënësi i fundit në vlerë të një page bazë,
- 9.2 për 20 vjet të përvijës së punës te punëdhënësi i fundit në vlerë të dy pagave bazë,
- 9.3 për 30 vjet të përvijës së punës te punëdhënësi i fundit në vlerë të tri pagave bazë,
- 9.4 punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblimin jubilar,
- 9.5 shpërblimi jubilar paguhet në afat prej një muaji pas plotësimit të kushteve.

10. punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) që dalin në pension përfitojnë pagesë përcjellëse në lartësi prej tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit.

Bazuar në këto dispozita ligjore dhe faktin që të gjithë paditësit kanë mbi 30 vite përvijë pune ju takojnë shpërblimi jubilar për 30 vjet të përvijës së punës të punëdhënësi i fundit në vlerë të tri pagave bazë dhe pagat përcjellëse në lartësi të tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit nga u vërtetua baza e kërkesëpadisë.

Gjykata vlerësoj pretendimet e palës së paditur mirëpo të njëjtat janë të pa qëndrueshme për faktin se paditësit janë pensionuar gjatë vitit 2016. Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e lidhur në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës është lidhur me 11 prill 2014 e cila është e aplikueshme në këtë çështje lëndore. Kontrata Kolektive e Arsimit Parauniversitar e lidhur në mes të Ministrisë së Arsimit e Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës së Kosovës ka hyrë në fuqi me datë 11 prill 2014 sa i përket implikimeve financiare ka filluar të zbatohet nga data 01 janar 2015 dhe nuk ka të bëjë me çështjen e shfuqizuar me nenin 48 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18 prill 2017 . Sa i përket planifikimit të buxhetit për pagat e tilla, paditësit

nuk mund të pësojnë lidhur me planifikimin e buxhetit dhe kostos buxhetore për zbatimin e kësaj Kontrate nga e organeve shtetërore. Andaj, pretendimet e tilla ishin pa ndikim në vendosjen ndryshe të çështjes, nga se nuk kishin mbështetje ligjore.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u murr bazuar në nenin 452.1 të LPK- së, ku pala e paditur ka detyrim në pagesën e shpenzimeve gjyqësore për taksë gjyqësore në shumat e cekura si në dispozitiv të Aktgjykimit.

Nga sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
C.nr. 692/ 18 , datë 27 dhjetor 2018

Gj y q t a r j a,
Afijete Sada Glllogjani

UDHËZIM JURIDIK; Kundër këtij Aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, pas marrjes së tij Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë nëpërmjet kësaj Gjykate.